



PUSHIME PA KËRCËNIME  
KIBERNETIKE






Edhe pse lidhja me Wi-Fi publik falas duket një ide e mirë, shpesh nuk është e sigurt dhe mund të ekspozojë pajisjet dhe informacionet tuaja personale ndaj hakerave.

# SHMANGNI WI-FI FALAS





Nëse lidheni me Wi-Fi publik, sigurohuni të konfirmoni emrin e rrjetit dhe të dhënat e tjera të sakta të hyrjes me stafin përkatës për të siguruar që rrjeti është i sigurt.

# KONFIRMONI RRJETIN





Nëse telefoni ose tabletin juaj lidhen automatikisht me rrjetet wireless ose pajisjet Bluetooth, çaktivizoni ato veçori dhe lidheni manualisht vetëm kur e keni të nevojshme.

**ÇAKTIVIZONI LIDHJEN  
AUTOMATIKE**



Tregoni kujdes për pajisjet tuaja si laptopi, telefoni, tableti apo edhe aksesorë si USB-të, veçanërisht gjatë lëvizjes dhe mos i lini pajisjet tuaja pa mbikëqyrje në vende publike.

# SIGURONI PAJISJET TUAJA



A photograph showing a person's hands using a laptop keyboard and a smartphone. In the background, there is a wooden desk with a coffee cup, a camera, and some papers. A blue tablet is also visible in the foreground.

Nëse përdorni kompjuterat në hotel apo vende të tjera që ofrojnë sisteme të përbashkëta, shmangni blerjet ose hyrjen në email apo llogari të tjera personale.

# SHMANGNI KOMPJUTERAT E PËRBASHKËT